

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

SikaCeram® EpoxyGrout

BOJAK EPOKSID ME 2 PËRBËRËS PËR FUGA ME GJERËSI NGA 2 DERI NË 20 MM, KATEGORIA RG SIPAS EN 13888



PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

SikaCeram® EpoxyGrout është bojak me 2 përbërës dhe me bazë rrëshire epokside, që përmban agregate kuarci dhe aditivë specifikë, ka finiturë delikate dhe ngjyra të shkëlqyeshme dhe është ideal për mjedise ku duhet të mbahet pastërti perfekte.

PËRDORIMET

- Stukim të dyshemeve qeramike ose prej guri* dhe pllakave mbi mure, si mozaikët prej qelqi ose mermeri, gres porcelani, klinker, në zona apo në sipërfaqe që mund t'i nënshtrohen sulmit acid apo në zona ku kërkohet bojak pllakash jo absorbues, si në vendet e përpunimit të qumështit, fabrikë lëkurash, fabrika letrash, laboratorë të të gjithë llojeve, thertore, kuzhina profesionale etj.
- Stukim i dyshemeve që i nënshtrohen qarkullimit së rendë, magazinave industriale, qendrave tregtare etj.
- I përshtatshëm për stukim të pllakave të pishinave edhe në rastet ku pishina është mbushur me ujë deti.

* Përpara stukimit mbi gurin natyror, këshillohet të kontrollohet lehtësia e pastrimit dhe nëse ndikohet ngjyra e gurit.

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

Baza kimike	Rrëshirë epokside, rërë kuarci dhe aditivë të posaçëm
Ambalazhi	Kovë plastike 2 kg dhe 5 kg (A+B)
Paraqitja / Ngjyra	Snow, ivory, agate, petra, moonstone, night (ju lutemi kërkoni katalogun e ngjyrave për ngjyrat e tjera) Përb. A: Pastë e trashë me ngjyrë / Përb. B: lëng viskoz
Jetëgjatësia	24 muaj nga data e prodhimit
Kushtet e magazinimit	Të ruhet në ambalazhin origjinal të mbyllur, në kushte të thata dhe i mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor, ngrirja dhe temperaturat e larta (max 35°C).

Dendësia	~ 1.60 kg/l
Përmasa maksimale e kokrrizës	$D_{max} = 0.2 \text{ mm}$

TË DHËNA TEKNIKE

Rezistenca ndaj abrazionit	$\leq 250 \text{ mm}^3$	(EN 12808-2)
Rezistenca ndaj ngjeshjes	Pas magazinimit në mjedis të thatë: $\geq 45 \text{ Mpa}$	(EN 12808-3)
Rezistenca ndaj tërheqjes në përkulje	Pas magazinimit në mjedis të thatë: $\geq 30 \text{ Mpa}$	(EN 12808-3)
Tkurrja	$\leq 1.5 \text{ mm/m}$	(EN 12808-4)
Rezistenca e ndërkapjes në tërheqje	Kushte standarde (pas 7 ditësh): ~ 5.6 N/mm ² Ps zhytjes në ujë: ~ 7.4 N/mm ² Pas shokut termik në ujë: ~ 2.5 N/mm ²	(EN 12003) (EN 12003) (EN 12003)

Rezistenca kimike

Acidet:

Emri	Përqëndrimi	Shërbim i vazhdueshëm +20°C	Shërbim jo i vazhdueshëm +20°C
Acetik	2.5	-	(+)
	5	-	-
	10	-	-
Hidroklorik	37	(+)	+
Kromik	20	-	-
Citrik	10	-	-
Formik	2.5	-	(+)
	10	-	-
Laktik	2.5	-	(+)
	5	-	-
	10	-	-
Nitrik	25	(+)	+
	50	-	-
Oleik		-	-
Fosforik	50	-	(+)
	75	-	-
Sulfurik	1.5	+	+
	50	(+)	+
	98	-	-
Tanik	10	(+)	+
Tartarik	10	(+)	+
Oksalik	10	+	+

Alkalet dhe tretësirat e ngopura:

Emri	Përqëndrimi	Shërbim i vazhdueshëm +20°C	Shërbim jo i vazhdueshëm +20°C
Amoniak	25	+	+
Sodë kaustike	50	+	+
Potasë	50	-	(+)
Hipoklorit natriumi:	6.5 g/l	(+)	+
Klor aktiv	162 g/l	-	-
Klor aktiv			

Tretësira të ngopura:

Emri	Përqëndrimi	Shërbim i vazhdueshëm +20°C	Shërbim jo i vazhdueshëm +20°C
Hiposulfit natriumi		+	+
Klorur natriumi		+	+
Klorur kalciumi		+	+
Klorur hekuri		+	+
Sulfat alumini		+	+
Sheqer		+	+
Peroksid hidrogjeni	1 10	(+) (+)	+
Bisulfit natriumi		(+)	+

Vajra dhe lëndë djegëse:

Emri	Përqëndrimi	Shërbim i vazhdueshëm +20°C	Shërbim jo i vazhdueshëm +20°C
Benzinë		+	+
Vajguri		+	+
Naftë		+	+
Vaj ulliri		+	+

Tretësit:

Emri	Përqëndrimi	Shërbim i vazhdueshëm +20°C	Shërbim jo i vazhdueshëm +20°C
Alkool etilik	15	-	(+)
Aceton		-	-
Glikol		+	+
Glicerinë		+	+
Perkloroetilen		-	-
Trikloroetan		-	-
Trikloroetilen		-	-
Klorur metileni		-	-
Toluol		-	-
Benzol		-	-
Xylol		-	-

Treguesi: + rezistencë e mirë; (+) rezistencë mesatare; - rezistencë e dobët

Përthithja e ujit	Pas 240 min: 0.1 g	(EN 12808-5)
Rezistenca ndaj rrëshqitjes	≤ 0.5 mm	(EN 1308)
Temperatura e funksionimit	-20°C deri në +100°C	
Gjerësia e fugës	2-20 mm	

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Raporti i përzjerjes

A:B = 94:6

Konsumimi

Konsumimi varet nga sipërfaqja dhe ashpërsia e nënshtresës si dhe gjithashtu nga përmasat e pllakave dhe hapësirat midis tyre. Sa për udhëzim, mbulimi tregohet në tabelën e mëposhtme, shprehur në g/m².

Përmasa e Gjerësia e fugës

pllakës

[cm]	2 mm	4 mm	6 mm	8 mm	10 mm
2x2x0.4*	1500	-	-	-	-
5x5x0.4	500	1000	-	-	-
10x10x0.6	380	770	1150	1550	1900
7.5x15x0.7	450	900	1350	1800	2200
15x15x0.9	380	770	1150	1550	1900
20x20x0.9	290	580	900	1150	1400
20x20x1.4	450	900	1350	1800	2240
12x24x0.9	-	720	110	1400	1800
12x24x1.4	-	1100	1700	2200	2800
20x30x0.9	240	480	720	960	1200
30x30x1	210	430	640	850	1100
30x60x1	160	320	480	640	800
40x40x1	160	320	480	640	800
50x50x1	130	260	390	510	640
60x120x1.1	90	180	270	350	440

* Mozaik qelqi

Temperatura e mjedisit

+12°C deri në +30°C

Temperatura e nënshtresës

+12°C deri në +30°C

Koha e punueshmërisë

~ 45 minuta*

Koha e përpunimit

~ 20 minuta*

Koha e pritjes

Përpara mbushjes së fugave lini:

- Mbushje fugash mbi dysheme me kollë normale: 24 orë*
- Mbushje fugash mbi dysheme me kollë me mpiksje të shpejtë: 4-6 orë*
- Mbushje fugash mbi llaç dyshemeje: 8-10 ditë*
- Mbushje fugash mbi mur me kollë normale: 5-6 orë*
- Mbushje fugash mbi mur me kollë me mpiksje të shpejtë: 2 orë*

Produkti i aplikuar gati për përdorim

- Qarkullim i lehtë këmbësorësh pas 24 orësh*
- Gati për përdorim pas 7 ditësh*

* Vlerat i referohen kushteve laboratorike: +23°C - lagështi relative 50%. Temperaturat e larta reduktojnë periudhën e treguar të kohës, ndërsa, përkundrazi, temperaturat e ulëta e zgjasin.

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

E pastër dhe e thatë, homogjene, pa vaj dhe graso, pluhur dhe grimca të lira apo të shkrifëta. Duhet të hiqen mbetjet e kollës së pllakës.

PËRZIERJA

SikaCeram® EpoxyGrout është bojak reaktiv. Kjo do të thotë se mpikset nëpërmjet një reaksioni kimik ndërmjet 2 përbërësve, A dhe B. Prandaj, është shumë e rëndësishme të sigurohet se dy përbërësit janë përzierë së bashku plotësisht. Vazhdoni duke hedhur lëngun (përb. B) tek pasta (përb. A) dhe përzieni me një mikser me aks spiral.

Reaksioni që ndodh është ekzotermik (zhvillim nxehtësie). Kini parasysh se nëse përbërësit janë përzierë në shpejtësi të lartë, nxehtësia e zhvilluar do të përshpejtojë ndjeshëm procesin e ngurtësimit dhe kështu, do të shkurtojë kohën e disponuar të punueshmërisë. Pasta e përfutur do të jetë kremoze dhe do të mund të përhapet lehtësisht me shpatull me gomë.

APLIKIMI

Aplikimi i produktit

SikaCeram® EpoxyGrout aplikohet me mallë me gomë për të mbushur fugat në të gjithë gjatësinë dhe thellësinë e tyre. Largoni materialin e tepruar me të njëjtën vegël.

Fleta e të dhënave të produktit

SikaCeram® EpoxyGrout

Tetor 2019, Botimi 04.01

020404010020000019

BUILDING TRUST



Pastrimi i pllakave

Shtrydhni një sfunger të zhytur në ujë mbi sipërfaqen e stukuar dhe duke përdorur një copë me fortësi mesatare, zbuteni produktin me lëvizje rrethore duke u kujdesur për të mos dëmtuar fugën. Pas pastrimit, ka shumë rëndësi që pllakat të mos kenë asnjë gjurmë bojaku, sapo produkti të jetë ngurtësuar mund të hiqet mekanikisht. Sfungeri duhet të shpëlahet shpesh gjatë pastrimit.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Heqja e mbetjeve të freskëta nga veglat dhe pajisja e aplikimit mund të bëhet me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar / tharë mund të hiqet duke përdorur SikaCeram® EpoxyRemover.

KUFIZIME

- Kontakti i gjatë me acidet dhe oksidantët shkakton ndryshim në ngjyrë.
- Mos përdorni raport të rastësishëm përzierjeje të dy përbërësve, pasi kjo gjë mund të prishë procedurën e saktë të fortësimit.
- Mos përdorni produktin që ka nisur të mpikset. Përgatitni një përzierje të freskët.
- Përdorni pajisje të përshtatshme mbrojtëse gjatë përdorimit dhe aplikimit të produktit.
- Mos e përdorni mbi nënshtresa poroze (p.sh. cotto)
- Mos përdorni SikaCeram® EpoxyGrout kur ka ujë nëpër fuga
- Mos e përdorni mbi ngjyrat e errëta të produktit mbi pllakat pa glazurë
- Mos e përdorni në fuga që i nënshtrohen lëvizjeve
- Mos lani me substanca acide apo shumë oksiduese gjatë aplikimit
- Vlerësoni lehtësinë e pastrimit përpara përdorimit mbi pllakat me natyrë/ prejardhje të veçantë.
- Shmangni grumbullimin e ujit tek fugat që janë stukuar së fundmi.

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park
Ndërtesa nr. 7, kati 4
Tiranë - Shqipëri
Tel.: +355 4 454 0070
alb.sika.com
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

SikaCeram® EpoxyGrout
Tetor 2019, Botimi 04.01
020404010020000019

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdoq afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdoq forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

SikaCeramEpoxyGrout-sq-AL-(10-2019)-4-1.pdf